



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KONISPOL

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**SISTEMI I NGROHJES, RRITJE E EFICENCËS ENERGJITIKE DHE TERRENE
SPORTIVE NË SHKOLLËN "BIDO SEJKO", KONISPOL**

- Fondi limit **48 988 639** (Dyzetë e tetë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë) Lekë , pa TVSH

(Financimi në dy vite, 9 994 735 lekë pa tvsh në vitin 2025 dhe 38 993 904 lekë pa tvsh në vitin 2026)

- Lloji procedurës së prokurimit: **E Hapur**
- Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: **45 ditë**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia KONISPOL**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 ”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe si dhe në Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar.

2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2023 dhe 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se fondi limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në pikën 2,b të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43, pika 2/b, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:* c) Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë vlerën e përlllogaritur të kontratës.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

- 2.2.2 Kopje të vërtetuara të balanceve të viteve ushtrimore 2022, 2023 dhe 2024 të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat

tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2024 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar), nga njësitë e qeverisjes vendore ku ka pasur selinë e zhvillimit të aktivitetit dhe ne të gjitha niptet sekondare qe operatori ka ne QKB. (Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë vërtetimin).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet,që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose,

b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- a. Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike ofertuesi duhet të paraqesë:
 - Formularin e vleresimit, shoqëruar me:
 - Kontratë
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes në dorezim.
 - Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;

(Në rastet e bashkimit të operatoreve të paraqitet kontrata noteriale e bashkëpunimit)

- b. Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat ofertuesi duhet të paraqesë:
 - Kontratë / vërtetime ku shënohet, vlera, koha dhe natyra e punës së bërë
 - Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
 - Formular vlerësimi, shoqëruar me aktin e kolaudimit dhe situacionin përfundimtar.
 - Leja e ndërtimit

(Në rastet e bashkimit të operatoreve të paraqitet kontrata noteriale e bashkëpunimit)

Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, ofertuesi duhet të paraqesë krahas dokumentacionit të mësipërm, dhe kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë :

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4.. në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën dhe pikës 5 të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

... Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, pika 8 *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Sipas këtij neni, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), ., Udhezimi i K.M nr.2 ,datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhezimin Nr.3 datë 15.02.2001 “Për Mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit “ te ndryshuar, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës për të vertetuar kërkesat e përcaktuara në nenin 39 pika 5/a dhe b, duhet të paraqesin Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit, Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim për punët e kryera me entet publike, që Autoriteti Kontraktor të bindet që operatori ekonomik me anë të dokumentacionit të paraqitur plotëson kriterin për punë të ngjashme ku shihen zërat e punimeve që ka realizuar, koha e realizimit, dokumentacioni i kolaudimit dhe marrjes në dorezim të objektit si dhe vlerësimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktor, elemente të nevojshme për të gjykuar për plotësimin e kriterëve për punë të ngjashme.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të deshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës.

Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008; *Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*", i ndryshuar.

Licensa profesionale e shoqërisë, e vlefshme, me kategoritë:

- NP-3 B Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
- NS-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
- NS-2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
- NS-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
- NS-12 B Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
- NS-14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj
- N.S. 18 A Punime topogjeodezike

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licensave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licensën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.." Lidhur me nivelin e kategorive në licensë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-3 B	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Gjithë zërat e punimeve	Niveli B	
NS-1 A	Punime për prishjen e ndërtimeve	Kreu I, shuma 1	Niveli A	
NS-2 A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina...	Kreu I, shuma 9	Niveli A	
NS-4 A	Punime rifiniture të muraturës...	Kreu I, shuma 3, 4, 5, 6	Niveli A	
NS-12 B	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.	Kreu V, shuma 1, 2, 3	Niveli A	
NS-14 A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj	Kreu II, shuma 4	Niveli A	
N.S. 18 A	Punime topogjeodezike	I nevojshëm për piketimi e fushave	Niveli A	

2.3.3 Ofertuesi duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve dhe e stafit të jetë jo më pak se **50** punonjës për **të paktën 3 muajt e fundit**.

Për përmbushjen e kësaj pike, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj në periudhën e lartëpërmendur.
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të konfirmuar nga autoriteti përkatës.
Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Bazuar në analizat e cmimeve për zërat e preventivit ku për çdo zë jepen orët e punës të nevojshme, makineritë që kërkohen në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës.

Ne lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kërkesë është e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.4 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
- Inxhinier Mekanik	1 (një)
- Inxhinier Gjeodet	1 (një)
- Inxhinier Elektrik	1 (një)
- Inxhinier Elektronik	1 (një)

- Arkitekt

1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune,
- Diplomën Universitare,

Drejtuesit teknik të projektit të jenë të përfshirë në listëpagesat e shoqërisë për të **paktën 3 muajt e fundit** dhe nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit.

*Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë **Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit.*

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 i ndryshuar

Inxhinierët janë përgjegjës për zbatimin e punimeve në përputhje me zërat e punimeve të preventivit ,projektit, specifikimeve teknike që do të zbatohen si dhe kategorive përkatëse në licencën përkatëse të zbatimit.

Inxhinieri gjeoet është i nevojshëm për zbatimin korrekt të objektit duke e piketuar sipas kuotave të projektit.

Për sa i përket kërkesës për arkitekt, është vendosur për të siguruar një qasje sa më estetike të objektit dhe terreneve sportive përreth tij.

2.3.5

2.3.5.1 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të kenë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesat e subjektit sipas kodit të profesionit të paktën **muajin e fundit**, punonjesit specialistë të kualifikuar, të vertetuar me dëshmi kualifikimi profesionale, diploma ose çertifikata të shkollës profesionale përkatëse për secilin specialitet të lëshuar nga institucione të liçensuara nga organet përkatëse, kontratë pune individuale ose të *kontraktuar në rastin kur makineritë janë me qira* (për manovratorët e shoferët), me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë si më poshtë:

- Teknik ndërtimi	1 (një)
- Teknik Mekanik	1 (një)
- Hidraulik	2 (dy)
- Elektracist	2 (dy)
- Teknik elektronik	1 (një)
- Hekurkthyes	2 (dy)
- Punonjes fasade	2 (dy)
- Punonjes gipsi	2 (dy)
- Pllakastrues	2 (dy)
- Hidroizolues	2 (dy)
- Suvatues	2 (dy)
- Bojaxhi	2 (dy)
- Saldator	1 (një)
- Betonues	1 (një)
- Specialist kondicionimi	2 (dy)
- Specialist duralumini	2 (dy)
- Automakinist	1 (një)
- Manovrator	2 (dy)
- Shofer	2 (dy)

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

Vendosja e ketyre kriterëve për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në si dhe mjeteve të kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

Kerkesa qe punonjesit e me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë është bere bazuar duke vlerësuar se operatorët ekonomikë duhet te paraqesin deshmi për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme sipas dispozitave te ligjit nr.8734, datë 1.2.2001 për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” i ndryshuar

Kerkesa per deshmite e manovratoreve bazohet ne Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”

2.3.5.2 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

- a) 1 (nje) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë").*
- b) 1 (një) specialist inxhinier i certifikuar /trajnuar për Specialist i Lartë për testimin e Performancës së Produkteve të Ndërtimit
- c) 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", Neni 49, pika 4.
- d) 1 (një) specialist Auditues Energjie

Punonjësit e mësipërm të jenë të certifikuar/ trajnuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Referuar përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, *ku aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës, është kërkuar personel i kualifikuar në lidhje me sigurinë në punë, kontrollin e cilësisë së materialeve të ndërtimit, performancës energjitike te objektit dhe fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.*

Këto kërkesa mbështeten dhe në legjislacionin sektorial për secilën pikë.

Ligji Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, Ligji Nr. 152/2015 "Per shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", Ligji Nr. 124/2015 Për efijencën e energjisë etj.

2.3.6 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton	2 copë	Në pronësi ose me qira
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës 6-7 tonë	1 copë	Në pronësi ose me qira
3	Kamion vetëshkarkues i pajisur me vinc me kapacitet mbajtës 8-10 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
4	Autobetoniere	1 copë	Në pronësi ose me qira
5	Eskavator me goma	1 copë	Në pronësi ose me qira
6	Autovinc me Kosh	1 copë	Në pronësi ose me qira
7	Minieskavator me zinxhirë	1 copë	Në pronësi ose me

			qira
8	Autopomp betoni	1 copë	Në pronësi ose me qira
9	Skeleri	2000 m2	Në pronësi ose me qira
10	Gjenerator 350 kë	2 copë	Në pronësi ose me qira
11	Aparat saldimi	2 copë	Në pronësi ose me qira
12	Gazogjen	2 copë	Në pronësi ose me qira
13	Pompë Suvatimi	3 copë	Në pronësi ose me qira
14	Makineri për shpërndarjen e Gomës në fushë + Aksesorët	1 copë	Në pronësi ose me qira
15	Fabrikë për prodhimin e betonit, të pajisur me dokumentacionin ligjor përkatës, (Leje ndërtimi, Leje Mjedisore Kodi III.1B, certifikate cilesie ISO 9001-2015 (e vlefshme) e vendosur jo më larg se 50 km nga objekti në pikën me kordinata 515286.52, 4391787.60 sipas sistemit KRGJSH.	1 copë	Në pronësi / me qira / kontrate furnizimi
16	Fabrikë për prodhimin e materialeve inerte, të pajisur me dokumentacionin ligjor përkatës, (Leje ndërtimi, Leje Mjedisore Kodi III.1B , Leje minerare).	1 copë	Në pronësi / me qira / kontrate furnizimi

2.3.6.1 Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 35 (Tridhjetë e pesë) copë;
 - Jelekë minimumi 35 (Tridhjetë e pesë) copë;
 - Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 2 (dy) copë;
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 6 (gjashtë) copë;
 - Fikse zjarri te levizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 (dy) copë;
 - Prozhektorë për ndriçim dhe kontroll suvatimi 6 (gjashtë) copë.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni si më poshtë:

- çertifikaten e pronesisë;
- leja e qarkullimit;
- siguracionin;
- çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- taksat vjetore
- leja e transportit që lëshohet nga njësia vendore dhe fotot përkatëse;

ndërsa për mjete të marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve si dhe fotografi.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve si dhe fotografi.
- Për pajisjet duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për pajisje të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Makineritë janë vendosur bazuar në zërat e preventivit, afatit dhe proceseve të punës për realizimin me sukses të veprës.

2.3.7 Për të përmbushur kërkesat e cilësisë në zbatim të legjislacionit në fuqi:

2.3.7.1

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikatat që kërkohen duhet të jenë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë të menaxhimit të cilësisë **ISO 9001 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën ISO nderkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).
- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë mbi sistemet e menaxhimit të ambientit **ISO 14001 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën ISO nderkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).
- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë **OHSAS 18001 / ISO 45001 (e vlefshme)** (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën ISO nderkohe që secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).
- Certifikatë Konformiteti **EN-ISO 3834-2:2021** Kerkesat e Cilësise për Saldimin e Materialeve Metalike;ose ekuivalente me standartet e adoptuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit

Çertifikatat të jenë në gjuhen shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara.

Argumentimi: Në zbatim të nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.7.2

- Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme” ose të kete kontrate shërbimi noteriale për objektin konkret me shoqëri të licensuara. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”). Licenca duhet të shoqërohet me akt miratimin.
- Operatorët Ekonomik duhet të jetë pajisur me Liçense për Mbrojtje nga Zjarri të lëshuar nga QKL, Kodi I.2.A.

Argumentimi: Referuar preventivit të punimeve,duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (*dheu, transportimi, prishje*), dhe kryerjen e transportit

të tyre në venddepozitimet e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 *“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 *“Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”* **ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B)** sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 *“Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”*, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 *“Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”*.

2.3.8 Në përputhje me kërkesat e cilësisë sipas specifikimeve teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

1. Materialet dhe paisjet e Kondicionimit
2. Materialet për Izolim
3. Materialet duroplastike të dritareve
4. Tubat të brinjëzuar HDPE SN8/SN4 të drenazhit të fushës së minifutbollit

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

1. Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributor i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
2. Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve të prodhuesit /ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

Argumentimi: Në zbatim të nenit 40 pika të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, AK duhet të sigurohet që materialet e mësipërme do të plotësojnë kërkesat e cilësisë referuar dhe rëndësisë së objektit në të cilin fëmijët kalojnë një pjesë të konsiderueshme të kohës.

Shënim:

Të gjitha dokumentat e kërkuara, provuese të kapaciteteve që deklarohen në shtojcën 8, nuk është e nevojshme të paraqiten në fazën e ofertimit në zbatim të nenit 82 të LPP dhe pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga projektuesi dhe janë pjesë e dosjes teknike

*Specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.